

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës F. D. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.3095/2015 të datës 08.07.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, të akuzuarës dhe mbrojtësit të saj avokat S. M. nga Prizreni, me datë 12.07.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### **E akuzuara:**

**F. D.** nga i ati F. dhe e ëma I. e lindur M., e lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer fakultetin e arkitekturës, arkitekthe, e pa martuar, me numër personal *numri personal...*, turke, shtetase e Republikës së Kosovës, e gjendjes së varfër ekonomike.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 22.09.2015 rreth orës 21:30 minuta, në Prizren saktësisht në kryqëzimin e rrugës ... duke e drejtuar automjetin e markës “Renault Clio” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, nuk i përmbahet dispozitave të komunikacionit në rrugë, shkel ligjin mbi trafikun publik, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, vepron në kundërshtim me nenin 54 e 150 të LSKRR, nuk i përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve dhe rrethanave në rrugë dhe gjatë lëvizjes përgjatë rrugës ... në drejtim të rrugës ... me të arritur në semafor e godet çiklistin, i cili në atë moment ishte duke lëvizur në rrugën ... për të cilin ishte ndezur drita e gjelbër në semafor, me ç’rast të dëmtuarit B. G. i shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës, dorës së majtë, thyerje të kockës metakarlea të gishtit të parë të dorës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme në shëndet.

**Kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK i shqipton:

### D Ë N I M M E K U S H T

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari B. (B.) G. nga fshati L. Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet e akuzuara të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin e komunikacionit shumen prej 40.88 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.3095/2015 të datës 08.07.2016, kundër të akuzuarës F. D. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarës. E akuzuara nuk e kundërshtoj provat materiale të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës dhe pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 22.09.2015 në ora 21:30 minuta, në Prizren në rrugën ..., si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor gjatë drejtimit të automjetit të udhëtarëve të markës “Renault Clio” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, shkel ligjin mbi trafikun publik dhe vepron në kundërshtim me nenin 54 dhe 150 të LSKRR, nga pakujdesia e rrezikon trafikun publik e vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nuk kushton kujdes të duhur pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, gjatë lëvizjes përgjatë rrugës ... në drejtim të rrugës ... me të arritur në semafor e godet çiklistin, i cili në atë moment ishte duke lëvizur në rrugën ... për të cilin ishte ndezur drita e gjelbër në semafor, me ç’rast të dëmtuarit B. G. i shkakton lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kokës, dorës së majtë, thyerje të kockës metakarlea të gishtit të parë të dorës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor, me pasoja të përkohshme në shëndet.

Gjykata para se të hap seancën fillestare – paraprakisht bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe bëri analizën e provave materiale dhe atë: ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Inxh. A. O. të datës 06.12.2015, ekspertizën e ekspertit të mjeksisë ligjore Dr. N. U. të datës 13.02.2016, raporti i Spitalit Regjional në Prizren – Qendrës Emergjent me numër të protokollit 3632 të datës 22.09.2015, skica e vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacionin, me ç’rast është vërtetuar se provat janë marrë në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe aktakuzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e bazuar në ligj. Provat në fjalë me kohë janë parashtruar të akuzuarës, me qëllim që të njëjtat të kundërshtoj dhe të parashtroj prova tjera të cilët do të shkojnë në favor të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së saj. Mirëpo në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas konsultimit me mbrojtësin e akuzuara deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat në të cilat mbështete aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK. Prandaj pasi që e akuzuara në seancën fillestare pranoi fajësisë dhe ky

pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, e cila mbështet në fakte dhe prova materiale, të cilat prova e akuzuara nuk i ka kundërshtuar, gjykata konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga nenit 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarës formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarën morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarës gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale e saj është i gjendjes së dobët ekonomike, kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së saj dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën e akuzuara është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1468/2016 të datës 12.07.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.